



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më __.08.2022

MBLEDHJA Nr. 34,
Datë 10.08.2022, ora 12:00
e Bordit të ERE-s

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Mërkurë, datë 10.08.2022, ora 12:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 34 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbaleve të mbledhjes së bordit të ERE-s më datë 21.07.2022 dhe më datë 03.08.2022
2. Mbi licencimin e shoqërisë “Egnatia Hydropower” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike
3. Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “EZ-5 Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik, me kapacitet të instaluar 10 MW, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3038, Fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, Qarku i Fierit
4. Mbi rinovimin e licencës nr. 373, seria T17, të shoqërisë “PPC Albania” sh.a., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 93, datë 04.07.2017
5. Mbi kërkesën e shoqërisë “Albpetrol” sh.a. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike
6. Mbi kërkesën e shoqërisë “Albpetrol” sh.a. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike
7. Mbi disa ndryshime në vendimin nr. 116, datë 24.05.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë “SPV Blue 1” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik “Blue 1” me vendndodhje në zonën e Sheq Marinas, Bashkia Fier, me kapacitet të instaluar 50 MW

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të

dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI
Petrit AHMETI